

There are no translations available.

Më 5 Maj 2012 në qytetin e Elbasanit u zhvillua Mbledhja e Keshillit Kombëtar të SPMSH nën drejtimin e Presidentit të Sindikatës z. Gëzim Kalaja.

Në zbatim të detyrimeve të Nenit 21 të Statutit të SPMSH dhe vendimeve të Këshillit Kombëtar të SPMSH datë 15 .10.2011 mbledhja e Këshillit Kombëtar përfundimisht

vendosi:

1. Të miratoj programin e fushatës zgjedhore paraqitur nga Kryesia e Përgjithshme e SPMSH .

2. Të miratoj numrin e përgjithshëm të delegatëve të Kongresit të Vltë të SPMSH bazuar në raportin e përfaqësimit të paraqitur nga Kryesia e Përgjithshme e SPMSH .

3. Mbi bazën e propozimit të bërë nga Kryesia e përgjithshme e SPMSH të miratoj si kandidatur të vetme në emër të Këshillit Kombëtar të SPMSH kandidatin për President të SPMSH z. Gëzim Kalaja . Ky vendim t'u bëhet i njohur të gjithë Konferencave Zgjedhore të Rajoneve Industriale , strukturave organizative të SPMSH dhe në emër të Këshillit Kombëtar të SPMSH kjo kandidaturë t'i paraqitet Kongresit të Vltë të SPMSH për miratim .

4. Për zhvillimin e punimeve normale të Kongresit të Vltë të SPMSH miratoi Komisionin e Verifikimit të Mandateve të delegatëve .

5. T'i propozjë për miratim Kongresit të Vltë të SPMSH , Komisionin e Votimit të Kongresit .